

20221502012

**LIGJ I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR
DETYRIMET SIPAS MARRËVESHJES SË HUASË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
TEN-T PËR AUTOSTRADËN NGA SHKUPI DERI NË KUFIRIN ME KOSOVËN, QË
DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM DHE NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes së huasë për financimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, që do të lidhet ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore në vlerë deri në 167.600.000 euro, nëse Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore nuk përmbush dhe servison detyrimet nga marrëveshja e huasë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë përcaktohen me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 1 të këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore për financimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që rezultojnë nga Marrëveshja e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji, si dhe servisimi i huasë do të kryhen nga Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore nga të ardhurat që realizon, brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji.

Neni 4

Afati i shlyerjes së huasë sipas nenit 1 këtij neni është 16 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej katër viteve. Huaja do të shlyhet me 24 këste gjysmëmujore në datë 20 mars dhe 20 shtator çdo vit.

Norma e interesit është variabile dhe përfshin EURIBOR gjashtëmujor të rritur me marginë prej 1%.

Ndërmarrja Publike të Rrugëve Shtetërore do t'i paguajë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm prej 1% të vlerës së huasë në afat prej shtatë ditëve nga dita e efektivitetit të huasë.

Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do t'i paguajë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0.5% të huasë në nivel vjetor.

Provizioni për mjetet e patërhequra të huasë do të fillojë të llogaritet pas 60 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huasë sipas nenit 2 të këtij ligji.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji dhe Marrëveshja e garancisë, Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i realizuar ndaj Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, të dedikuara për realizimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 i këtij ligji është liruar nga tatimi i vlerës së shtuar me të drejtë të zbritjes (heqjes) së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave i realizuar nga Ndërmarrja Publike të Rrugëve Shtetërore, të dedikuara për realizimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji është liruar nga tatimi i vlerës së shtuar, detyrimet importuese, si dhe nga akciza e energjensave dhe tatimi i automjeteve të udhëtimit.

Për qarkullimin që është realizuar ndaj Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, i dedikuar për realizimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji, ku i njëjti është debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pika 4 dhe nenin 32-a nga Ligji për tatim mbi vlerën e shtuar është liruar nga detyrimi i llogaritjes dhe pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve, i kryer ndaj realizuesit të përzgjedhur nga ana e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore që do t'i realizojë punët kontraktuese, të dedikuara për realizimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 i këtij ligji është liruar nga tatimi i vlerës së shtuar me të drejtë të zbritjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave, i kryer nga realizuesi i përzgjedhur nga ana e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, të dedikuara për Projektin TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji është liruar nga tatimi i vlerës së shtuar, detyrimet importuese, si dhe nga akciza e energjensave dhe tatimi i automjeteve të udhëtimit.

Për qarkullimin që është kryer ndaj realizuesit të përzgjedhur nga ana e Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, i cili do t'i realizojë punët kontraktuese të dedikuara për realizim të Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji, ku i njëjti është debitor tatimor në përputhje me nenin 32 pika 4 dhe nenin 32-a nga Ligji i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar është liruar nga detyrimi i llogaritjes dhe pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafët 1, 3, 4 dhe 6 të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (titullit) të pranuesit të të mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë e shënon edhe emrin e projektit dhe emrin e Marrëveshjes së huasë sipas nenit 2 të këtij ligji.

Realizuesi i përzgjedhur gjatë importit të të mirave/mallrave të liruara në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i parashtron kopje të Marrëveshjes së huasë sipas nenit 2 të këtij ligji, vërtetim nga Ndërmarrja Publike të Rrugëve Shtetërore se realizuesi është përzgjedhur që të kryejë punë kontraktuese për qëllimet e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji.

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve nga paragrafët 4 dhe 6 të këtij neni, si dhe importi i të mirave/mallrave nga paragrafi 5 i këtij neni, nuk mund ta tejkalojë vlerën e marrëveshjes ndërmjet Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore dhe realizuesit të përzgjedhur për realizimin e punëve kontraktuese, të dedikuara për realizimin e Projektit TEN-T për autostradën nga Shkupi deri në kufirin me Kosovën, financuar me Marrëveshjen e huasë sipas nenit 2 të këtij ligji.

Neni 7

Pë realizimin e lirimit sipas nenit 6 paragrafi 2 dhe 5 të këtij ligji, Ndërmarrja Publike të Rrugëve Shtetërore, përkatësisht realizuesi i përzgjedhur, parashtron kërkesë në Ministrinë e Financave – Drejtoria Doganore.

Forma dhe përmbajtja e kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe dokumentacioni përkatës përcaktohen nga ministri i Financave.

Neni 8

Të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 dhe 5 të këtij ligji, në afat prej tre viteve nga dita e importit, nuk mund të tjetërsohen, t'i jepen në shfrytëzim dikujt tjetër, të huazohen ose ndryshe të shfrytëzohet për qëllime tjera, dhe jo për ato që janë liruara nga pagesa e detyrimeve importuese, para se të jenë paguar detyrimet importuese. Këto nuk guxojnë të jepen si kolateral, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse poseduesi i së drejtës, para përfundimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, të mirat/mallrat që kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve importuese në bazë të nenit 6 paragrafi 2 dhe 5 të këtij ligji, ka për qëllim t'i shfrytëzojë për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat janë liruara nga pagesa e detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Vlerën e borxhit doganor nga paragrafi 2 të këtij neni, organi doganor e llogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve që ishin të plotëfuqishme në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, vlera e borxhit doganor llogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës malli është liruara nga pagesa e detyrimeve importuese.

Neni 9

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 60 ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.